



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

UDHËZUES

PËR MONITORIMIN QYTETAR
TË TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES
PËR NJËSITË E VETË-QEVERISJES VENDORE



Institute for Democracy and Mediation

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

UDHËZUES

**PËR MONITORIMIN QYTETAR
TË TRANSPARENCËS
DHE LLOGARIDHËNIES
PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**



Përgatiti Udhëzuesin:

Dr. Ardita Shehaj

Eksperte në Fushën e Transparencës dhe Politikat Antikorrupsion

Kontribuese:

Lorena Totoni

Eksperte e Qeverisjes Vendore

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA).




Norwegian Embassy



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

1. Hyrja	5
2. Transparenca në njësitë e vetëqeverisjes vendore	11
3. Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies	15
3.1 Monitorimi i transparencës gjatë situatave të emergjencave apo fatkeqësive natyrore	18
3.2 Aktorët monitorues të transparencës	19
3.3 Sistemi i Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies (ITL) në nivel bashkie	21
4. SHTOJCA	52
Shtojca 1. Mësime të nxjerra nga procesi i pilotimi të sistemit të matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies në 12 bashki	52

HYRJA



Transparenca vlerësohet si një nga elementët kryesore të mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ndërsa aksesit në informacion cilësohet ndryshe si oksigjeni i demokracisë. Ligji mbi të drejtën e informimit u garanton qytetarëve të drejtën për të aksesuar dokumente zyrtare, duke detyruar institucionet publike të jenë transparente. Transparenca nënkupton jo vetëm vënien në dispozicion të informacionit, qoftë ky informacion me karakter ekonomik, politik apo ligjor, por edhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve në mënyrë të hapur me publikun. Në nivelin vendor, informimi publik konsiderohet si baza e ndërveprimit dhe çelësi i marrëdhënieve të besueshme midis komunitetit dhe qeverisjes vendore. Veprimtaria e institucioneve monitorohet lehtësisht nga komuniteti, media, OSHC-të dhe grupe të ndryshme interesi kur informacioni i bërë publik nga institucionet publike është lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm.

Aksesi në informacion luan një rol kyç në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies si dhe në parandalimin e korrupsionit, ndaj është jetike që institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor të publikojnë në kohë dhe në mënyrë të plotë informacionin e kërkuar nga publiku dhe grupet e ndryshme të interesit. Gatishmëria e dhënies së informacionit nga institucionet publike rrit përgjegjshmërinë e tyre në shërbimin ndaj qytetarëve.¹ Duke qenë se transparenca krijon mundësinë që qytetarët të analizojnë veprimet dhe vendimet e institucioneve, duhet që e drejta për informim të garantohet bazuar në disa parime kryesore, të cilat po i listojmë më poshtë:

P A R I M I 1

Parimi i hapjes maksimale, që nënkupton se, në çdo rast, informacionet në institucionet publike duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme. Institucionet publike kanë detyrimin të japin informacion për veprimtarinë e tyre dhe çdo qytetar ka të drejtë ta kërkojë informacionin, pa shpjeguar arsyet.

P A R I M I 2

Institucionet publike duhet të jenë të detyruara të publikojnë në mënyrë proaktive informacionet e rëndësishme për publikun, pa detyruar këtë të fundit të bëjë kërkesa për informacion. Të gjitha institucionet publike duhet të publikojnë informacione për veprimtarinë e tyre, buxhetin, auditimet, prokurimet publike, vendimmarrjet etj. sikurse e kërkon ligji mbi të drejtën e informimit.

...

1 Transparency International, E drejta e informimit për dokumentet zyrtare në Shqipëri (e aksesueshme në <http://tia.al/wp-content/uploads/2013/11/foiOk.pdf>)

P A R I M I 3

Institucionet publike duhet të promovojnë qeverisjen e hapur. Në shumë vende, institucionet kanë punuar me dekada për të forcuar kulturën dhe ndryshuar mendësitë që informacionet e institucioneve publike janë konfidenciale apo sekret. Një rezultat i tillë ka ardhur kryesisht si pasojë e dy faktorëve:

1. Nëpunësit nuk e kuptojnë detyrimin e tyre për të mbajtur publikun të informuar;
2. Publiku nuk e kupton të drejtën e tij për të qënë i informuar.

Por, për të pasur transparencë sa më të lartë duhet që të dyja sfidat e sipërpërmendura të përmirësohen. Funkionarët publikë duhet të trajnohen për të ndryshuar qasjen e tyre ndaj transparencës dhe publiku duhet edukuar për të ushtruar të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare. Ky udhëzues shërben pikërisht si një instrument që mund të ndikojë në përmirësimin e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC-të), si dhe në nxitjen e tyre për të monitoruar transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve vendore.

P A R I M I 4

Kufizimet e të drejtës për informim duhet të jenë të qarta dhe të sakta, si dhe t'i nënshtrohen testit të "interetit publik" dhe testit të "dëmit të shkaktuar". Këto dy teste duhet të zhvillohen nga institucionet për atë kategori informacioni që mund të kufizohet dhe ato analizojnë faktorët pro dhe kundër bërjes publike të informacionit.

Duhet theksuar se transparencia është e rëndësishme sepse u mundëson Organizatave të Shoqërisë Civile dhe qytetarëve të monitorojnë dhe kontrollojnë punën e institucioneve dhe nëpunësve publikë. Aksesit në informacion është një instrument për të parandaluar punën e dobët, shkeljet, abuzimet me pushtetin dhe korrupsionin, si dhe u mundëson individëve të ushtrojnë saktë të drejtën për të votuar, të drejtën e iniciativës legjislative, adresimin e të drejtave të veçanta etj.

Por transparencia është e rëndësishme edhe për vetë autoritetet publike, sepse u mundëson atyre që të informojnë publikun mbi vendimmarrjen e tyre, si dhe të promovojnë punën dhe integritetin e punonjësve. Në rastin e njërive të vetëqeverisjes vendore, publikimi i dokumenteve të politikave vendore i siguron publikut informacionin e nevojshëm për të qenë pjesë aktive në politikëbërje dhe vendimmarrje. Publikimi proaktiv i informacionit të njërive të vetëqeverisjes vendore rregullohet nga Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Ligji Nr.139/ 2015, mbi "Vetëqeverisjen Vendore" si dhe nga një sërë ligjesh të tjera.

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzuesi është forcimi i kapaciteteve të OSHC-ve për të monitoruar në mënyrë objektive transparencën dhe llogaridhënien në nivelin e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur instrumentin e matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies për monitorimin e rregullt të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor.

Target grupi kryesor

Target grupi kryesor i përdoruesve të këtij udhëzuesi përfshin përfaqësuesit e OSHC-ve dhe mediave vendore, të cilat njihen me detajet e programit të transparencës dhe sistemit të matjes së transparencës dhe llogaridhënies nëpërmjet sesioneve të trajnimit. Më tej udhëzuesi shërben si një instrument bazë për të gjitha OSHC-të, qytetarët dhe aktorët e tjerë për realizimin e procesit të monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies në 61 bashkitë e vendit.

Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës

Përveç publikimit të informacionit në rubrikën Program Transparence, një fazë tjetër shumë e rëndësishme për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor është monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Monitorimi lejon të vlerësohet niveli i transparencës në nivel bashkie, si dhe parimi i llogaridhënies vertikale dhe horizontale sipas dy dimensioneve: nga institucionet publike dhe nga aktorët jopublik. Llogaridhënia horizontale ka të bëjë me mbikëqyrjen që kryejnë institucionet e specializuara ndaj pjesës tjetër të institucioneve të administratës publike, p.sh. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron nëse bashkitë zbatojnë të gjitha detyrimet që duhet të përmbushin në kuadër të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; ndërsa llogaridhënia vertikale ka të bëjë me përfshirjen e qytetarëve apo organizatave të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes apo në monitorimin e nivelit të transparencës.

Instrumenti bazë

Instrumenti bazë për monitorimin është Sistemi i Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies i hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit “Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR 2”. Ai shoqëron Programin e Transparencës së bashkive dhe lehtëson ofrimin e dhënies së informacionit me interes publik në kohë dhe mënyrë efektive, duke kontribuar në zbatimin e legjislacionit mbi të drejtën e informimit dhe konsultimit publik në nivelin vendor. Monitorimet e kryera deri tani nuk kanë qenë të shumta, ndaj në këtë kontekst vjen në ndihmë pikërisht ky udhëzues monitorimi.

Hartimi i këtij udhëzuesi mori në konsideratë inputin e ofruar nga aktorët vendorë gjatë konsultimit të raporteve monitoruese të Transparencës dhe Llogaridhënies në 12 bashki qendër qarku (Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë). Këto tryeza vendore u realizuan në kuadër projektit “Monitorimi Qytetar i Transparencës dhe Llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore”.² Përdorimi i udhëzuesit gjatë realizimit të ushtrimit të monitorimit qytetar të performancës së 12 bashkive në fokus në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien, ishte përpjekja e parë për pilotimin e Sistemit të Matjes duke e validuar atë si edhe duke përdorur qasjen me pjesëmarrje për ta përshtatur me kontekstin e qeverisjes vendore. Pilotimi i këtij sistemi monitorimi qytetar në të gjitha bashkitë e vendit, stabilizimi i qendrave burimore që do të kryejnë monitorimin e rregullt në intervale vjetore, krijimi i një renditjeje kombëtare vjetore përsa i përket indeksit të performancës në lidhje me Transparencën dhe Llogaridhënien do të krijojnë presion social dhe incentiva për përmirësimin nga ana e bashkive të instrumenteve të komunikimit dhe ndërveprimit me qytetarët. Në përfundim, përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies së bashkive për shkak të forcimit të kapaciteteve të monitorimit qytetar do të ndihmojë në arritjen e një qeverisjeje më të hapur, llogaridhënëse dhe me pjesëmarrje, që do të ndikojë në uljen e korrupsionit në nivelin e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri. Mësimet e nxjerra nga aktorët monitorues dhe përvoja e përftuar gjatë ushtrimit të monitorimit qytetar të performancës së 12 bashkive janë paraqitur dhe përmbledhur

....

- 2 Përgjatë periudhës Shtator-Tetor 2020, 12 OSHC vendore, përmes asistimit teknik të IDM-së, kanë monitoruar dhe vlerësuar Programin e Transparencës (PT) të publikuar në faqen zyrtare të internetit të 12 bashkive. Kjo iniciativë vijon punën dhe angazhimin e mëhershëm të IDM-së në lidhje me hartimin e Programit model të Transparencës në nivelin e qeverisjes vendore dhe Sistemin përkatës të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies. Qëllimi i këtij ushtrimi monitorues lidhet me përmirësimin e zbatimit të së drejtës së informimit nëpërmjet monitorimit dhe kontributit që mund të japin OSHC-të vendore në zbatimin efektiv të ligjit.

në udhëzues (shtojca 1). Ato përbëjnë një vlerë të shtuar të tij dhe shërbejnë për përmirësimin e monitorimit të zbatimit të Programit të Transparencës së Bashkive nga palët e interesuara, qytetarët dhe aktorët monitorues si OSHC-të dhe mediat vendore. Për hartimin e udhëzuesit është shfrytëzuar gjithashtu edhe përvoja ekzistuese mbi proceset e monitorimit qytetar në vende të tjera të Evropës e më gjerë.³

....

- 3 da Cruz, Nuno Ferreira, Tavares, António F., Marques, Rui Cunha, Jorge, Susana and de Sousa, Luís (2015) Measuring local government transparency. Public Management Review . ISSN 1471-9037, Tools to Support Transparency in Local Governance UN-HABITAT (United Nations Human Settlements Programme) and Transparency International. Urban Governance Toolkit Series HS/702/04E ISBN: 92-1-131694-4, Ackerman, John. 2004. "Co-governance for Accountability: Beyond 'Exit' and 'Voice.'" World Development 32 (3): 447–63 E. Calossi S. Sberna A. Vannucci (&) University of Pisa 2012, Disasters and Corruption, Corruption as Disaster, A. de Guttry et al. (eds.), International Disaster Response Law, DOI: 10.1007/978-90-6704-882-8_27

TRANSPARENCA
DHE LLOGARIDHËNIA
**NË NJËSITË
E VETËQEVERISJES VENDORE**

Transparenca dhe e drejta për informim për njësitë e vetëqeverisjes vendore garantohen dhe janë të parashikuara në disa akte ligjore. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përkatësisht në nenin 23, përcaktohet se:

E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Por kjo e drejtë nuk garantohet vetëm nga Kushtetuta, por edhe nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky ligj përcakton në radhë të parë përkufizimin e informacionit publik, që përfshin çdo të dhënë të regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Gjithashtu, ligji e grupon informacionin në dy kategori të mëdha:

1. Informacioni i bërë publik me kërkesë – ka të bëjë me atë kategori informacioni që kërkohet nga qytetarët nëpërmjet një kërkesë zyrtare;
2. Informacioni i bërë publik pa kërkesë – ka të bëjë me informacionin që institucionet janë të detyruara të publikojnë në faqet e internetit, apo siç njihet në terminologjinë e ligjit program transparence.

Në nenin 7 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” janë parashikuar të gjitha kategoritë e informacionit që duhet të përmbajë programi i transparencës, ndërsa në nenin 6 është parashikuar që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri) miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike. Komisioneri, me Urdhrin Nr. 211, datë 10.09.2018, miratoi programin model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky program transparence i dedikuar për njësitë e qeverisjes vendore u hartua nga IDM-ja në kuadër të projektit STAR2, dhe për të garantuar transparencë maksimale ka marrë në konsideratë jo vetëm Kushtetutën dhe Ligjin 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si edhe ligjin Nr. 8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Referuar urdhërit të Komisionerit, duhej që bashkitë të kishin hartuar dhe miratuar programin e ri të transparencës brenda datës 1 janar 2019. Informacioni i publikuar pa kërkesë, apo siç njihet ndryshe transparencë proaktive, duhet të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

- Të jetë i aksesueshëm për të gjithë qytetarët informacioni që ka të bëjë me veprimtarinë e institucionit, duke filluar me buxhetin, informacione mbi prokurimet publike, kuadrin ligjor ose rregullator, kontratat e koncesioneve, CV-të e punonjësve dhe subjektet që deklarojnë pasuritë e tyre, organigramën etj.
- Ligjshmëria, transparenca dhe antidiskriminimi. Aksesit në informacion duhet të sigurohet në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, por duke i dhënë përparësi ligjit për të drejtën e informimit.
- Ofrimi i informacionit falas. Tarifat e vendosura për vënien në dispozicion të informacionit publik konsiderohen si një pengesë për të aksesuar informacion publik. Për këtë arsye, transparenca proaktive mundëson që një pjesë e madhe e informacioni të bëhet publik në faqet e internetit, duke siguruar kështu akses falas për të gjithë qytetarët. Ndërsa në rastet kur informacioni i kërkuar është voluminoz, duhet të ofrohet kundrejt një tarife të përcaktuar.
- Akses për këdo. Aksesit në informacion duhet t'u ofrohet të gjithëve, duke i dhënë gjithashtu një fokus të veçantë grupeve më të prekura të shoqërisë dhe shtresave në nevojë (të varfërve, të papunëve, personave të marginalizuar, personave me aftësi të kufizuara, si dhe minoriteteve).

Është shumë e rëndësishme që informacioni i vënë në dispozicion të qytetarëve të jetë:

» i plotë	» i kuptueshëm
» i saktë	» lehtësisht i aksesueshëm
» i përditësuar	» në përputhje me dokumentet origjinale të institucionit përkatës
» i lehtë për t'u shqyrtuar	» lehtësisht i përdorshëm






Duke marrë në konsideratë të gjitha parimet e mësipërme, programi i transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore është organizuar në 7 fusha kryesore, të tilla si:

- 1.** Organizimi dhe funksionimi i bashkisë;
- 2.** Llogaridhënia ekonomiko-financiare;
- 3.** Shërbimet publike;
- 4.** Kërkesat për informacion publik dhe të dhënat e koordinatorit;
- 5.** Legjislacioni dhe aktet e brendshme;
- 6.** Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje;
- 7.** Informacione që lidhen me procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.

Për secilën prej fushave të mësipërme është detajuar lista e dokumenteve, si dhe baza ligjore e rregullatore përkatëse. Në mënyrë të detajuar lista e dokumentacionit që duhet të publikohet në programin e transparencës, gjendet në Aneksin I. Duhet theksuar se programi i transparencës mund të rishikohet një herë në pesë vjet, ndërsa përditësimi i tij duhet të bëhet rregullisht.

MONITORIMI
**I TRANSPARENCËS
DHE LLOGARIDHËNIES**



Një nga fazat e rëndësishme për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor është monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës. Disa nga arsyet pse monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies vendore është i rëndësishëm janë:

- **Nxit pjesëmarrjen qytetare dhe forcon demokracinë**

Monitorimi i transparencës ndikon në rritjen e besimit qytetar, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje. Informacioni në vetvete nuk është pushtet, por është mjeti kryesor që sjell pushtet dhe që ndihmon në ushtrimin e shumë të drejtave në një shoqëri demokratike. Publiku është i aftë të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes publike kur zotëron informacion për aktivitetet dhe politikat e qeverisë, si dhe kur njerëzit mund të shohin se cilat përfitime dhe shërbime u takojnë. Qytetarët mund të marrin pjesë në vendimmarrjet e bashkive nëpërmjet mendimeve apo oponencës së tyre, vetëm nëse kanë informacion mbi aktivitetet dhe politikat qeveritare. Mjeti kryesor për të siguruar një informacion të tillë është transparenca. Ndërgjegjësimi i publikut dhe krijimi i mundësive që ata të jenë pjesë e procesit të konsultimit publik të projekteve që mund të miratohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të përmirësojë mbështetjen e qytetarëve dhe të reduktojë pakënaqësitë e tyre. Besimi në institucione përmirësohet nëse qytetarët janë në dijeni të vendimeve që do të miratohen në të ardhmen dhe nëse mendimi i tyre është marrë në konsideratë. Sidoqoftë, edhe në rastet kur mendimet e qytetarëve apo grupeve të ndryshme të interesit nuk merren në konsideratë, institucionet duhet të japin argumentet përkatës.

- **Nxit mirëfunksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore**

Transparenca është një parim i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe funksionimit të institucioneve vendore. Detyrimi që iu lind bashkive për të bërë publike vendimmarrjen e tyre, sjell që këto vendime të jenë sa më objektive dhe realiste. Gjithashtu, transparenca cilësohet si mjeti kryesor* në luftën kundër korrupsionit, pasi bën që njësitë e vetëqeverisjes vendore të bëjnë publike të gjitha transaksionet që kryejnë, kontratat që lidhin për ofrimin e shërbimeve publike nga subjekte private (kontratat e partneritetit privat-publik), të gjitha procedurat e prokurimit publik, apo çdo shpenzim që kryhet nga fondet publike. Në këtë mënyrë, qytetarët kanë të drejtë të informohen

....

si për veprimtarinë ashtu edhe për vendimmarrjen e qeverisë. E drejta për informim mund të përdoret për t'u informuar mbi të gjitha mbi të dhënat e kontratave konçensionare, mënyrën se si është përzgjedhur kompania fituese apo auditimet që i bëhen kompanisë. Mundësia për të pasur akses në një gamë të gjerë informacioni i detyron edhe më shumë institucionet që të jenë më të përgjegjshme para një vendimmarrje dhe të kenë nivel më të lartë llogaridhënie ndaj publikut. Gjithashtu, transparenca shërben për të promovuar parandalimin e veprimtarive korruptive nga ana e funksionarëve publikë, dhe pikërisht për këtë arsye është pjesë e Konventës kundër Korrupsionit dhe përbën objektivin kryesor në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit.⁵

● Promovon llogaridhënien

Llogaridhënia është një nga tiparet kryesore të qeverisjes së mirë, sepse pa llogaridhënie nuk mund të gjurmohen rrënjët e dështimeve në qeverisje dhe nuk mund të korrigjohen ato. Llogaridhënia në nivel vendor siguron ekzistencën e një mekanizmi, i cili bën të mundur që si të zgjedhurit vendorë ashtu edhe zyrtarët e administratës vendore të jenë përgjegjës për veprimet e tyre, performancën dhe përdorimin e burimeve publike. Zbatimi efektiv i të drejtës për informim i aftëson dhe fuqizon qytetarët për të kërkuar llogari dhe identifikuar përgjegjësitë tek zyrtarët vendorë, duke nxitur efektivitetin dhe ndjenjën e llogaridhënies tek ata, gjë që ndikon në uljen e korrupsionit në nivelin e vetëqeverisjes vendore.

● Siguron drejtësi dhe gjithëpërfshirje

Kjo nënkupton se të gjithë qytetarët gëzojnë të drejtën për t'u bërë pjesë e qeverisjes dhe të ndihen të përfshirë në vendimmarrje duke patur një status të barabartë. Gjithashtu, e drejta për informim nuk bën asnjë diskriminim midis shtresave shoqërore, duke përfshirë të gjithë qytetarët dhe duke luajtur njëkohësisht një rol të rëndësishëm për të siguruar drejtësi dhe barazi sociale.

....

5 Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 http://www.mod.gov.al/images/PDF/Strategjia_Antikorrupsion2015_2020.pdf

3.1 Monitorimi i transparencës gjatë situatave të emergjencave apo fatkeqësive natyrore

Monitorimi i transparencës dhe llogaridhënies merr një rëndësi të veçantë kryesisht gjatë situatave të emergjencave apo fatkeqësive natyrore. Në Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” sanksionohet edhe “Parimi i informimit” si një nga parimet bazë të procesit të menaxhimit të emergjencave civile. Ai garanton të drejtën e informimit të publikut për rreziqet dhe aktivitetet e institucioneve qendrore, vendore dhe të tjera, përgjegjëse për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Duke ju referuar rasteve të emergjencave civile të viteve të fundit në vend, (tërmetet e shtatorit dhe nëntorit të vitit 2019), shpallja e “Gjendjes së fatkeqësisë natyrore” në tre qarqe të Shqipërisë u shoqërua nga një program masash të jashtëzakonshme (Akt normativ Nr. 9, 16.12.2019) i quajtur “Programi i rindërtimit”. Programi u caktoi bashkive kompetenca menaxhuese të lidhura me administrimin e fondeve të rindërtimit, planifikimin dhe zhvillimin e territorit në funksion të procesit të rindërtimit, krijimin dhe menaxhimin e bazës së të dhënave për subjektet e dëmtuara si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit.

Në funksion të transparencës së përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit është krijuar portali unik qeveritar “Shtëpia ime” i cili përdoret nga strukturat përgjegjëse menaxhuese të bashkive të prekura. Në publikimin e informacionit përdoren për aq sa është e mundur, parimet e Open Data dhe përfshihen këto informacione:

- a) Programi kombëtar i rindërtimit;
- b) të dhëna mbi fondin e rindërtimit, burimin e krijimit të tij, kontributet në para dhe kontributet në natyrë dhe mënyrën e shpenzimit të këtij fondi;
- c) projektet e realizuara;
- ç) zonat e zhvilluara dhe zonat në zhvillim;
- d) vendimet e autoriteteve përgjegjëse;
- dh) të dhëna mbi procedurat e prokurimit në funksion të procesit të rindërtimit.

Informacionet e sipërpërmendura dhe disa kategori të tjera informacioni të lidhura me to, duhet të jenë subjekt i monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel vendor.


Në këtë kontekst ka rëndësi që të monitorohet me kujdes jo vetëm dokumentacioni që përmban programi i transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore, por edhe informacione specifike të tilla si rimbursimet e qirave, kompensimet e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, kriteret e aplikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm për kompensimet, si dhe vendimmarrja e bashkive. Gjatë situatave të emergjencës, monitorimi i transparencës do të ndikonte pozitivisht, kryesisht përsa i përket menaxhimit të fondeve publike, pasi gjatë periudhave të tilla procedurat e prokurimeve publike janë më të shumta dhe monitorimi i transparencës nga aktorë të ndryshëm krijon presion që njësitë e vetëqeverisjes vendore të jenë më të përgjegjshme për të publikuar çdo procedurë si dhe për të ruajtur besimin e publikut. Një përfitim tjetër që do të sillte transparenca është parandalimi i rritjes së çmimeve apo parandalimi i veprimtarive korruptive.

Edhe pse kategoritë e informacionit që lidhen me transparençën dhe llogaridhënien gjatë situatave të emergjencave apo fatkeqësive natyrore nuk përfshihen më vehte në Sistemin e Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies të përdorur gjatë këtij procesi monitorimi, ato janë monitoruar të shpërndara sipas rubrikave përkatëse të PT dhe kategorive ekzistuese të informacionit në websitet e bashkive.

3.2 Aktorët monitorues të transparencës


Aktorët të cilët mund të monitorojnë nivelin e transparencës si dhe nivelin e zbatueshmërisë së ligjit janë të shumtë:

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është institucioni i cili ka detyrimin ligjor për të monitoruar respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit, për të dhënë rekomandimet si dhe sanksionet përkatëse ndaj bashkive;
2. Këshilli Bashkiak mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë;
3. Kryetari i bashkisë mbikëqyr procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë dhe njësive administrative e të varësisë;
4. Aktorët jopublikë, ku përfshihen organizatat e shoqërisë civile, media, biznesi, qytetarët dhe grupe të ndryshme interesi, kanë një rol të rëndësishëm si mbikëqyrës dhe monitorues të zbatimit të Programit të Transparencës. Këta aktorë shërbejnë si instrumenta efektiv për të ushtruar “presion” ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore për më shumë llogaridhënie, apo për renditjen e bashkive sipas nivelit të transparencës, duke nxitur në këtë mënyrë konkurrencën mes tyre.



Pavarësisht faktit që ka disa aktorë të ndryshëm në monitorimin e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies së bashkive, përfshirja e shoqërisë civile në procesin e monitorimit ka avantazhet e veta, sepse vlerësimi është i pavaruar dhe identifikimi i problematikave është më real.

SISTEMI I MATJES
**SË TRANSPARENCËS
DHE LLOGARIDHËNIES**



Sistemi i Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies analizon një grup treguesish të transparencës dhe llogaridhënies me qëllim për të matur dhe raportuar në mënyrë periodike nivelin e transparencës të secilës bashki. Një sistem i tillë i shërben të gjithë aktorëve, duke filluar nga:

- bashkitë, pasi mundëson evidentimin e pikave të dobta dhe të forta për secilën bashki;
- Komisionerit, sepse i vë në dispozicion një instrument të unifikuar monitorimi në përputhje me Programin Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- aktorëve të tjerë si p.sh. OSHC-të apo mediave, të cilët duke monitoruar transparencën e institucioneve me anë të këtij instrumenti, ndikojnë në rritjen e llogaridhënies së bashkive.

Sistemi i Matjes ka për qëllim të realizojë një vlerësimin objektiv të të gjithë dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës, sipas parashikimeve të nenit 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të grupuar në 7 fusha kryesore. Secila fushë është ndarë në nënfusha dhe për secilën nënfushë janë përcaktuar indikatorët përkatës. Indikatorët treguesit janë përzgjedhur duke u bazuar në përgjegjësitë, kompetencat, funksionet, dhe procedurat përkatëse të njësive të vetëqeverisjes vendore që përcaktohen në kuadrin ligjor në fuqi. Në total, për 7 fushat ka 147 indikatorë të cilët kanë të gjithë të njëjtën peshë. Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i indikatorëve dhe pikëve për secilën nga 7 fushat e programit të transparencës:

Tabela nr. 1: Fushat dhe indikatorët

Fusha	Nënfusha	Indikatorë	Pikë
I: Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë	4	32	64
II: Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare	10	29	58
III: Kërkesat për informim	8	23	46
IV: Shërbimet që ofron bashkia	3	15	30

Fusha	Nënfusha	Indikatorë	Pikë
V: Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore	1	6	12
VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje	9	32	64
VII: Informacion tjetër	4	10	20

Secili indikator paraqet një dokument apo informacion i cili duhet të publikohet nga bashkitë dhe të jetë lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët. Gjithashtu, indikatorët synojnë të masin nivelin e transparencës së bashkive, si dhe shërbejnë për të vlerësuar gatishmërinë e zyrtarëve vendorë për të qenë të hapur ndaj qytetarëve dhe gjithëpërfshirës në vendimmarrje.

Çdo indikator mund të vlerësohet me 0, 1 dhe 2 pikë, në bazë të sasisë dhe cilësisë së informacionit që rezultojnë në lidhje me të nga monitorimi. Monitoruesi shënon me X vlerësimin përkatës, duke marrë në konsideratë faktin se vlerat që mund të marrin indikatorët janë:

- **V = 0** Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm;
- **V = 1** Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë;
- **V = 2** Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme.

Bazuar në pikëzimin e çdo indikatorit llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki. Ky pikëzim mund të shërbejë për të parë jo vetëm pikët totale të secilës bashki, por dhe për t'i krahasuar bashkitë me njëra-tjetrën. Gjatë monitorimit të nivelit të transparencës duhet të llogaritet dhe indeksi i transparencës, që është raporti midis rezultatit të pikëzimit që del nga monitorimi me maksimalen e mundshme të pikëve për çdo bashki. Duke përdorur tabelën e shkallëzuar në kuantile të Sistemit të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies, bëhet specifikimi relativ i shkallës së transparencës dhe llogaridhënies në njësinë përkatëse. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur një ndarje e niveleve të transparencës në 5 grupime të mëdha:

1. transparencë e ulët;
2. transparencë pjesërisht e ulët;
3. transparencë mesatare;

4. transparencë pjesërisht e lartë;
5. transparencë e lartë.

Tabela nr. 2: Kategoritë e transparencës

Pikët totale	Kuantilet në bazë të pikëve totale	Kategoria e performancës
Kuantil 1 (0-59 pikë)	0-20%	Transparencë e ulët
Kuantil 2 (60-118 pikë)	20-40%	Transparencë pjesërisht e ulët
Kuantil 3 (119-177 pikë)	40-60%	Transparencë mesatare
Kuantil 4 (178-235 pikë)	60-80%	Transparencë pjesërisht e lartë
Kuantil 5 (236-294 pikë)	80-100%	Transparencë e lartë

Shembull ilustrues i llogaritjes së pikëzimit për nënfushën e parë të fushës së parë.

Marrim në analizë bashkinë X. Klikojmë në faqen zyrtare të internetit të bashkisë X dhe shkojmë në rubrikën e emërtuar Program Transparence. Pasi të kemi aksesuar programin e transparencës së bashkisë X, duhet të analizojmë nëse janë të publikuara dokumentacionet e renditura në tabelën nr.2. Për këtë shembull ilustrues marrim në analizë vetëm indikatorët e nënfushës 1 të fushës së parë. Supozojmë se, nga monitorimi i faqes së internetit, Bashkia X për nënfushën e parë merr vetëm 3 nga 6 pikë maksimale. Në të njëjtën mënyrë vijohet me të gjithë indikatorët e nënfushave të tjera. Në fund, shuma e pikëve të nënfushave jep totalin e pikëve për bashkinë X dhe ky total del 148. Për këtë bashki indeksi i transparencës është i barabartë $148/294 \cdot 100 = 50.3\%$. Nëse do t'i referohemi kategorizimit të transparencës me kuantile, bashkia X është në kuantilin e tretë, me një nivel mesatar transparence.

Tabela 3: Llogaritja e pikëzimit në nivel nënfushe

Fusha I - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë (32 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i Pikëve
1. Organizimi administrativ-territorial, misioni dhe funksionet (3 indikatorë)	a. Të dhëna për ndarjen administrativ-territoriale të bashkisë (Njësitë administrative dhe nënndarjet e tyre)	X			0
	b. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misioni i bashkisë		X		1
	c. Funksionet (sipas 7 fushave të funksioneve të veta dhe 1 fushë të funksioneve të deleguara)			X	2
Totali nënfusha 1. Organizimi administrativ-territorial, misioni dhe funksionet Max = 6 pikë					3

Matrica e llogaritjes

Sistemi i Matjes së Transparencës dhe
Llogaridhënies (ITL) në nivel bashkie



Fusha I Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë (32 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i pikëve
1. Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet (3 indikatorë)	a. Të dhëna për ndarjen administrativo-territoriale të bashkisë (Njësitë administrative dhe nëndarjet e tyre)	X			0
	b. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misioni i bashkisë		X		1
	c. Funksionet (sipas 7 fushave të funksioneve të veta dhe 1 fushë të funksioneve të deleguara)			X	2
Totali nënfusha 1. Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet		Max = 6 pikë			
		3			

2. Organete bashkisë (15 indikatorë)	a) Përbëria dhe strukturat (anëtarët, kryetari i këshillit, sekretari i këshillit, komisionet, grupet e këshilltarëve)				
	b) Detyrat dhe kompetencat e KB-së				
	c) Rregullorja e KB-së				
	d) Kalendari i mbledhjeve të KB-së				
	e) Njoftimet për mbledhjen e KB-së				
	f) Rendi i ditës së KB-së				
	g) Projekt-vendimet në proces shqyrtimi në KB				
	h) Procesverbalet e mbledhjeve të KB-së				
	i) Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ				
	Kryetari i Bashkisë: a) Procedurat e zgjedhjes				

Fusha I Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë (32 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i pikëve
	b) Detyrat dhe kompetencat (Kryetari i bashkisë)				
	c) Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe paga e kryetarit				
	d) Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ				
	e) Orari i pritjes së qytetarëve				
	f) Adresa postare/ elektronike				
Totali nënfusha 2: Organet e bashkisë		Max = 30 pikë			

Fusha I Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë (32 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i pikëve
